Atij që shpik në çështjen (fenë) tonë diçka që nuk është e saj, i refuzohet

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Atij që shpik në çështjen (fenë) tonë diçka që nuk është e saj, i refuzohet." (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi) Në motërzimin e Muslimit qëndron: "Atij që bën ndonjë vepër që nuk është në përputhje me çështjen (fenë) tonë, i refuzohet."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti në këtë hadith sqaron se kushdo që shpik në fe ose bën diçka për të cilën nuk ka argument nga Kurani dhe Suneti, ajo do t'i refuzohet vepruesit të saj dhe do të jetë e papranueshme tek Allahu.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/4792